



nuk kishte përdorur telefonin gjatë drejtimit të automjetit. Por çuditërisht punonjësit e policisë e shoqëruan atë në Komisariatin e Policisë Fier dhe plotësuan proceverbalin e konstatimit të shkeljes me nr. serie 9686657 dhe i vendosën 7000 (shtatë mijë) lekë gjobë pa patur asnjë provë.

Gjithashtu ankuesi shkruan se, punonjësit e policisë i kanë thënë atij se ata nuk e kanë parë atë duke përdorur telefonin gjatë drejtimit të automjetit, por për këtë fakt u kishte thënë shefi i tyre në radio.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, i kërkuam Drejtorisë Vendore të Policisë Fier që ta verifikonte këtë ankesë dhe të na dërgonte shpjegime lidhur me sa më poshtë:

“1. Cili është qëndrimi i këtij organi lidhur me pretendimet e ankuesit se gjoba i është vendosur në mënyrë të padrejtë sepse ai nuk e ka përdorur aparatit e telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit?

2. Çfarë provash janë administruar nga punonjësit e Sektorit të Trafikut Urban (foto, video, etj) për të provuar faktin se ankuesi ka kryer shkeljen e dispozitave të Kodit Rrugor, përdorimin e aparatit të telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit?

3. Cili është shkaku dhe baza ligjore e shoqërimit të ankuesit në Komisariatin e Policisë Fier?

4. Dërgimin e fotokopjeve të materialeve shkresore që janë administruar lidhur me këtë rast.”

Drejtorja Vendore e Policisë Fier me shkresën nr. 1898/1 prot., datë 08.03.2022 na informoi se, në datën 05.02.2022, ora 09:15, në rrugën Fier - Patos, përballë karburant “Kastrati”, drejtuesi E.B. është konstatuar nga Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban, duke përdorur aparatit e telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit. Për shkeljen e konstatuar, Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban, ka njoftuar patrullën e policisë rrugore që kryente shërbim në këtë aks rrugor në vendin e quajtur “Kthesa e Patosit” me qëllim që të merrte masë administrative ndaj tij. Patrulla e Policisë Rrugore e përbërë nga Inspektor Ilo Ngjela dhe Skënder Hoxha, e ka ndaluar automjetin me targë AA 808 PS, i ka komunikuar drejtuesit të mjetit arsyen e ndalimit dhe i ka kërkuar dokumentet, lejen e drejtimit dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

Drejtuesi i këtij mjeti ka paraqitur lejen e qarkullimit ndërsa lejen e drejtimit nuk ia ka dhënë, pasi nuk ishte dakord me shkeljen e konstatuar. Pas kërkesave të përsëritura të punonjësve të policisë ai ia ka dhënë lejen e drejtimit dhe ndërkohë ka filluar që të filmojë me kamera veprimet e patrullës së policisë. Patrulla ka gjykuar që në rrethanat e krijuara e ka patur të pamundur marrjen e masës administrative dhe i ka kërkuar Sallës Operative ndihmë për shoqërimin e drejtuesit të mjetit në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Veprimet e kryera në këtë rast nga punonjësit e policisë rrugore janë pasqyruar me raport ngjarje në Menaxhimin e Çështjes me nr. Unik 202202050890.

Pas shoqërimit në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 11, 12, 171 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative”, pika A/1, është përpiluar proceverbali i konstatimit të shkeljes me nr. serie 9686657, datë 05.02.2022. Për shkeljen e kryer, shtetasit E.B. i është vendosur gjobë në masn 7.000 (shtatë mijë) lekë. Kjo praktikë është shoqëruar me raport shërbimi të përpiluar nga shërbimi i patrullës së Policisë Rrugore dhe Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se në datën 07.02.2022, shtetasi E.B. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier. Ky komision me vendimin nr. 41, datë 24.02.2022 “Për shqyrtim ankese” dhe vendimin nr. 118, datë 24.02.2022 “Për shqyrtimin e kundërvajtjes”, ka vlerësuar të rregullt konstatimin e agjentëve verifikues dhe ka lënë në fuqi masën e dhënë nga patrulla e Policisë Rrugore me procesverbalin nr. serie 9686667, datë 05.02.2022.

Bashkëlidhur me informacionin Drejtoria Vendore e Policisë Fier na dërgoi edhe fotokopjet e procesverbalit të konstatimit të shkeljes me nr. serie 9686657, datë 05.02.2022, të raportit të shërbimit, të dy vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, respektivisht me nr. 41, datë 24.02.2022 dhe nr. 118, datë 24.02.2022, si dhe të raportit të ngjarjes me nr. Unik 202202050890.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, por nisur edhe nga shqetësimi i ngritur në disa ankesa të tjera të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit kohët e fundit të cilat kanë të njëjtin objekt, kundërshtimin e masave administrative të vendosura nga punonjësit e Policisë Rrugore për përdorimin e telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit, si dhe të masave administrative të vendosura në mungesë të drejtuesve të automjeteve, evidentojmë se shkeljet e konstatuara nuk shoqërohen me prova, sikurse mund të jenë foto, video, etj. Ne vlerësojmë se shoqërimi i procesverbaleve të konstatimit të shkeljes të përpiluara nga agjentët verifikues me foto, video, etj., është i nevojshëm dhe do t'i shërbente procesit të provueshmërisë së shkeljes administrative të dispozitave të Kodit Rrugor të kryer nga drejtuesit e automjeteve. Dokumentimi i shkeljes administrative mund të realizohet nëpërmjet aparateve të telefonit celular që kanë punonjësit e policisë, mjeteve të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, si dhe nga sistemi i monitorimit me kamera të instaluar nga entet publike në rrugë, në kryqëzime, semaforë, etj.

Këtë vlerësim e bazojmë në Kodin e Procedurës Administrative, respektivisht në Seksioni 2 “Mjetet e kërkimit të provës”. Më konkretisht, në nenin 80 të tij të titulluar “Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës” parashikohet se:

*“1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:*

*a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;*

*b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;*

*c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.*

*2. Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për atë që është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.*

*3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.”*

Ndërsa, detyrimi i organeve të administratës publike për të provuar ligjshmërinë e akteve administrative parashikohet në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se:

*“1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, ....”.*

Gjithashtu ky detyrim parashikohet edhe në nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* të ndryshuar, ku përcaktohet se:

*“Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për rastin e shtetasit E.B., konstatohet se shkelja ligjore, përdorimi i telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit, e kryer nga drejtuesi i automjetit me targë AA 808 PS, është konstatuar nga Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban dhe jo nga patrulla e Policisë Rrugore e përbërë nga Inspektor Ilo Ngjela dhe Inspektor Skënder Hoxha, të cilët kanë qenë në distancë disa kilometër nga konstatuesi. Patrulla e Policisë Rrugore e ka ndaluar drejtuesin e automjetit mbi bazën e njoftimit të bërë nga Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban. Pra, në këtë rast, edhe sikur ta marrim të mirëqënë konstatimin e bërë për shkeljen ligjore të kryer nga drejtuesi i automjetit E.B., procesverbali i konstatimit duhet të ishte plotësuar nga konstatuesi, punonjësi i Policisë Rrugore, Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban dhe jo punonjësi i patrullës së Policisë Rrugore Ilo Ngjela, sikurse është bërë në fakt.

Veprimet e punonjësve të Sektorit të Policisë Rrugore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe procedura e kryer në rastin e shtetasit E.B. vjen në kundërshtim të plotë dhe të

hapur me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimin e gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar me udhëzimet nr. 74, datë 13.03.2014 dhe nr. 292, datë 17.06.2016, gërma “C” “Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor”.

Referuar këtij udhëzimi, rasti në fjalë është një rast tipik i konstatimit/evidentimit në mungesë të kundërvajtjes administrative në fushën e qarkullimit rrugor nga Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban. Mirëpo ky punonjës nuk ka zbatuar procedurën e parashikuar në këtë udhëzim, respektivisht në gërmën C/I/2, 3 e 4 ku parashikohet se:

*“2. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të normave të qarkullimit në mungesë të drejtuesit të mjetit, punonjësi i policisë vepron si më poshtë:*

*a) Njofton menjëherë sallën e komandimit sipas juridiksionit territorial, duke raportuar këto të dhëna: tipin, targën e mjetit, vendndodhjen, shkeljen e konstatuar, duke specifikuar sinjalistikën rrugore ekzistuese, numrin e serisë së procesverbalit të konstatimit që do të plotësojë.*

*3. Punonjësi i shërbimit të sallës së komandimit në juridiksionin territorial dhe punonjësi i shërbimit të sallës së drejtimit, koordinimit e emergjencave të Komisariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, në rastet kur marrin njoftim për konstatimet e shkeljeve të normave të qarkullimit rrugor në mungesë, vepron si më poshtë:*

*a) Plotëson menjëherë të dhënat e marra në regjistrin model-1 bashkëlidhur. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë kronologjike për çdo rast të raportuar. Mosplotësimi në kohë dhe saktë i regjistrit përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës të fillojë ecuria disiplinore në bazë të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit.*

*4. Punonjësi i policisë në përfundim të shërbimit i raporton dhe i dorëzon eprorit të drejtëpërdrejtë ose atij të caktuar në këtë detyrë, origjinalin dhe kopjen e tretë të procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë për verifikim dhe evidentim të mëtejshëm sipas procedurave të përcaktuara më lart në këtë udhëzim.*

*Në këto raste, eprori i drejtëpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë, bën, përveç kontrollit të saktësisë së plotësimit të procesverbalit, dhe evidentimin e bërë në sallën e drejtimit, koornidimit e emergjencave sipas pikës 2/a.”*

Pra, Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban në vend që të zbatonte procedurën e cituar më sipër, duke njoftuar sallën e komandimit e plotësuar procesverbalin në mungesë të drejtuesit/pronarit të automjetit, e ka shkelur atë. Ai është mjaftuar me njoftimin e patrullës së Policisë Rrugore për ta ndaluar e proceduar drejtuesin e automjetit E.B..

Patrulla e Policisë Rrugore, e përbërë nga Inspektor Ilo Ngjela dhe Inspektor Skënder Hoxha, gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me procedurën e cituar më sipër, sepse ndonëse nuk e ka konstatuar drejtuesin e mjetit në shkelje të normave të Kodit Rrugor, e ka ndaluar atë dhe ka plotësuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes sikur ta kishte evidentuar vetë atë.

Shkelja e procedurës të parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar, nga punonjësit e Policisë Rrugore nuk është konstatuar as nga Organi Administrativ Shtetëror në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier (OASH) gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës së shtetasit E.B.. Ky është tregues i faktit se shqyrtimi administrativ nuk është bërë i plotë, objektiv dhe profesional, por ka qenë formal dhe i njëanshëm. Ndërkohë që referuar nenit 81 të Kodit të Procedurës Administrative, *OASH-ja me cilësinë e organit publik gjatë këtij procesi duhet të çmonte, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.*

Gjithashtu nga këqyrja me kujdes i përmbajtjes së vendimit të OASH-së nr. 118, datë 24.02.2022 konstatojmë se ky akt administrativ nuk është përpiluar sipas modelit (Lidhja 4) të udhëzimit të cituar më sipër, sepse në stemë mungon emërtimi i këtij organi. Ndërkohë që në përmbajtje ka pasaktësi në emërtimin e këtij organi dhe konkretisht në pjesën hyrëse emërtohet “Organ Administrativ” ndërsa në vijim emërtohet “Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative”.

Po ashtu, në këtë vendim konstatojmë se edhe e drejta ligjore e ankimit të kundërvajtësit ndaj këtij vendimi është vendosur në fund të fletës, poshtë emrave të anëtarëve të Organit Administrativ Shtetëror dhe nënshkrimeve të tyre, sikur të jetë një “footnote”/shënim sqarues apo plotësues në fund të faqes dhe jo si pjesë përbërëse e vendimit, sikurse përcaktohet në modelin (Lidhja 4). Këto elemente janë pjesë të rëndësishme të një vendimi administrativ. Sjellim në vëmendje se, referuar neneve 99<sup>1</sup> dhe 100<sup>2</sup> të KPA, mungesa e

---

<sup>1</sup> Neni 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik”

*1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.*

*2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:*

*a) pjesën hyrëse, që përmban:*

*i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;*

*ii) palët të cilave u drejtohet akti;*

*iii) datën e miratimit;*

*iv) bazën ligjore;*

*b) pjesën arsyetuese;*

*c) dispozitivin që tregon:*

*i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;*

*ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;*

*iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.*

<sup>2</sup> Neni 100 “Arsyetimi i aktit”

elementëve të domosdoshëm sikurse janë: *qëllimi, pjesa hyrëse (emri i organit publik që nxjerr aktin; palët të cilave u drejtohet akti; pjesa arsyetuese; e drejta e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afati dhe mënyra e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit)*, e bëjnë të paligjshëm një akt administrativ.

Përveç shkeljes së procedurës së parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar, patrulla e Policisë Rrugore ka vijuar më tej shkeljen e të drejtave të shtetasit E.B., duke i privuar lirinë nëpërmjet shoqërimit të tij në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Vlerësojmë të sjellim në vëmendje se e drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në mjediset e organeve të policisë, rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit, përgjegjësitë e punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar, dokumentimi i shoqërimit në polici dhe rregullat teknike të shoqërimit janë parashikuar

---

*Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:*

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;*
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;*
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;*
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.”*

në mënyrë shumë të qartë në nenet 6/25<sup>3</sup>, 109<sup>4</sup> dhe 122/1<sup>5</sup> të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në kreun V “Rastet dhe qëllimet e aplikimit të shoqërimit” të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” parashikohet se:

---

<sup>3</sup> Neni 6 “Përkufizime”

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

25. “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

<sup>4</sup> Neni 109 “Shoqërimi në polici”

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;
- ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;
- d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;
- dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;
- e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;
- ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
- f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjeneralitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

<sup>5</sup> Neni 122 “Masat mbrojtëse”

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.



***“Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj, si:***

- A. Për identifikimin e personit;
- B. Si masë mbrojtëse;
- C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj;
- D. Sqarimin e një rrethane.”

Nga përgjigjja e dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, të cilën e përshkruam më sipër, rezulton se shoqërimi i shtetasit E.B. është bërë për shkak se “*ai pasi u ka dhënë lejen e drejtimit ka filluar që të filmojë me kamera/aparat celular veprimet e patrullës së policisë dhe se patrulla ka gjykuar që në rrethanat e krijuara e ka patur të pamundur marrjen e masës administrative.*”

Nga përmbajtja e akteve normative të cituara më lart, evidentohet qartazi se nuk parashikohet e drejta e punonjësve të policisë për të shoqëruar një person për shkak se ai po “*filmon me kamera/aparat celular veprimet e patrullës së policisë*”. Pra, shoqërimi i tij në ambientet e policisë është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin dhe në procedurën standarde të punës.

Është rasti që të theksojmë se problemin e shoqërimit të shtetasve në mjediset e Policisë së Shtetit e kemi trajtuar disa herë nisur nga ankesat e ardhura nga qytetarët, si dhe nga konstatimet e bëra gjatë inspektimeve dhe vizitave të kryera në strukturat vendore të këtij organi. Lidhur me këtë problematikë kemi bërë disa rekomandime drejtuar strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit nëpërmjet të cilave kemi kërkuar trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë që ta ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me aktet normative në fuqi dhe vetëm në rastet e kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese. Por, pavarësisht faktit që rekomandimet tona janë vlerësuar të drejta dhe pranuar nga strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit, në praktikën e përditshme ende ka raste abuzimi me këtë të drejtë ligjore nga punonjësit e policisë. Për më tepër, shih rekomandimet:<sup>6</sup>

---

6

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20korrekt%C3%ABsi%20t%C3%AB%20rasteve%20dhe%20kriterive%20ligjore%20t%C3%AB%20shoqerimit%20te%20shtetasve%20ne%20ambientet%20e%20oraganeve%20te%20Policise%20se%20Shtetit.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%20nevojshme%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20rigorozitet%20t%C3%AB.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20korrekt%C3%ABsi%20t%C3%AB%20kriterive%20ligjore%20lidhur%20me%20shoq%C3%ABrimin%20e%20shtetasve%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20Policise%20s%C3%AB%20Shtetit.%20si%20dhe%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20t%C3%AB%20personave%20t%C3%AB%20shoq%C3%ABruar..pdf>

Përveç sa më sipër, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, kemi konstatuar se Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr. 687, datë 05.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimin e gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar me udhëzimet nr. 74, datë 13.03.2014 dhe nr. 292, datë 17.06.2016, nuk është përditësuar e përshtatur në zbatim të ndryshimeve të fundit që ka pësuar Kodi Rrugor me ligjin nr. 63/2021, datë 07.05.2021 dhe posaçërisht neni 201 “Shqyrtimi i kundërvajtjes nga organi administrativ”, i cili ka ndryshuar procedurën e shqyrtimit të kundërvajtjeve. Më konkretisht në këtë nen përcaktohet:

*“Kundërvajtjet sipas këtij Kodi, shqyrtohen vetëm në bazë të ankesës së shtetasve kundërvajtës nga organi administrativ shtetëror në territorin e të cilit është efektiv agjenti verifikues, ose nga organi administrativ ku ka adresën e banimit kundërvajtësi, organe të cilat marrin vendimin përkatës.*

Në vlerësimin tonë, marrja e dy vendimeve ndaj shtetasit E.B., brenda të njëjtës datë, nga OASH-së në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, respektivisht me nr. 41, datë 24.02.2022 “Për shqyrtim ankese” dhe nr. 118, datë 24.02.2022 “Për shqyrtimin e kundërvajtjes”, është pasojë e mos kuptimit e zbatimit të drejtë të nenit 201 të Kodit Rrugor të ndryshuar me ligjin nr. 63/2021, datë 07.05.2021, si dhe e mos reflektimit të procedurës së re për shqyrtimin e kundërvajtjeve në udhëzimin e cituar më sipër.

Sjellim në vëmendje se, është detyrim ligjor që ndryshimet e Kodit Rrugor të reflektohen në aktet normative nënligjore që janë nxjerrë në bazë dhe për zbatimin e tij, sikurse është edhe Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr. 687, datë 05.12.2013, i ndryshuar, sepse ky Kod dhe neni 201 i tij është një nga referencat në bazë të të cilit ai ka dalë. Ndaj, duhet të merren masat e nevojshme për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin dhe përmirësimin e Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar, në përputhje me ndryshimet e bëra Kodit Rrugor me ligjin nr. 63/2021, datë 07.05.2021 dhe dërgimin e tij për miratim Ministrisë të Brendshme.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në nenin 21/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”, në nenin 24/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: b) t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e

*fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.”, si dhe në nenet 108/a/ii/iii; 109/b/c; 110/1/2 dhe 111 të Kodit të Procedurës Administrative, të cilët i kemi cituar më sipër,*

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e shkeljeve ligjore të kryera ndaj drejtuesit të mjetit, shtetasit E.B., nga punonjësit e Policisë Rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, Specialisti i Menaxhimit të Trafikut Urban dhe Interurban, Inspektor Ilo Ngjela dhe Inspektor Skënder Hoxha, si dhe anëtarët e OASH-së Gentian Dervishaj, Bashkim Bushi e Flatun Hoxhaj, të cilët nuk kanë zbatuar procedurën e parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar, si dhe kanë bërë shoqërimin e tij në organin e policisë në kundërshtim me aktet normative në fuqi.
2. Nxjerrjen e përgjegjësive ligjore të secilit prej tyre, fillimin e ecurisë disiplinore dhe ndëshkimin me masa administrative përkatëse.
3. Marrjen e masave për plotësimin e vendimit të OASH-së me elementët e domosdoshëm të një vendimi administrativ dhe konform modelit (Lidhja 4) të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar.
4. Ndryshimin e praktikës së deritanishme të punës së punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë atributet e agjentit verifikues sipas parashikimit të Kodit Rrugor, të cilët në rastet e konstatimit të shkeljeve të rregullave në fushën e qarkullimit rrugor, krahas plotësimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes të administrojnë edhe prova të tjera për të dokumentuar/provuar shkeljen e kryer nëpërmjet pajisjeve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, sikurse parashikohet në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë Rrugore për njohjen e rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit.
6. Përgjithësimin e shkeljeve ligjore të konstatuara gjatë shqyrtimit të këtij rasti në të gjitha strukturat e Policisë Rrugore në shkallë vendi me qëllim mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.
7. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projektit për ndryshimin dhe përmirësimin e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 687, datë 05.12.2013, të ndryshuar, në përputhje me ndryshimet e bëra Kodit Rrugor me ligjin nr. 63/2021, datë 07.05.2021 dhe dërgimin e tij për miratim, Ministrit të Brendshëm.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**